

Pyetjet e pranuarra përmes e-mail-it dhe përgjigjet e tyre

Nr.	Pyetjet e parashtruara nga aplikuesit potencial	Përgjigjet e MZHR-së
1.	Pyetja ime eshte se ne nuk kemi bere asnje shitje apo qarkullim pasi qe jemi ne fazen investive. A kualifikohemi ne per prefitim te grantit pasi qe nuk kemi pase qarkullim nga shitja po vetem qarkullim me mjete vetanake per ndertim te objektit afarist.	- Sipas kushteve të thirrjes, aplikuesit duhet të kenë qarkullim vjetor të deklaruar në ATK për vitin 2025 në vlerë prej 10,000 euro deri në 300,000 euro.
2.	Kam nevoje per perkrahje finaciare per blerjen e paisjeve per ushqim dhe ventilim per ritje te zogjeve.	- Sipas Udhëzuesit për aplikim, sektori i bujqësisë, përfshirë pajisjet dhe aktivitetet që lidhen me veprimtari bujqësore, nuk kualifikohet për financim në kuadër të kësaj thirrjeje.
3.	Në kuadër të thirrjes është përcaktuar kriteri i qarkullimit vjetor, I cili minimalisht parashihet të jetë 10 mijë euro për vitin 2025. Në rastet kur një biznes individual i plotëson shumicën e kriterëve profesionale dhe administrative, por eventualisht nuk arrin pragun e kërkuar të qarkullimit, madje për pak fare ose është mbi 7 mijë euro qarkullimi i tij vjetorë, a ekziston mundësia e shqyrtimit të aplikimit apo ky kriter është strikt dhe përjashtues?	- Kriteri i qarkullimit vjetor prej 10,000 euro deri në 300,000 euro për vitin 2025 është kriter i detyrueshëm i pranueshmerisë për aplikim në këtë thirrje.
4.	Duke marrë parasysh rëndësinë e mediave lokale në informimin publik dhe zhvillimin demokratik të komunitetit, dëshiroj të di nëse në kuadër të kësaj thirrjeje parashihet mbështetja edhe për media të vogla lokale dhe portale informative, veçanërisht në aspektin e pajisjeve teknologjike dhe avancimit profesional, si: pajisje për zërim, ndricim, realizim, etj, e që përbëjnë domosdoshmërinë e avancimit nga video-xhirime në shesh në realizime skenike dhe në studio adekuate?	- Mediat lokale dhe portalet informative mund të aplikojnë në kuadër të kësaj thirrjeje, me kusht që të plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në Udhëzuesin për aplikim, përfshirë kriteret e qarkullimit, regjistrimit të biznesit dhe veprimtarisë ekonomike.
5.	A lejohet që fondet e grantit të përdoren për blerjen e pajisjeve nga Kina?	- Pajisjet mund të blihen edhe nga furnizues jashtë Republikës së Kosovës, me kusht që ato të jenë në përputhje me projektin e miratuar, të jenë pajisje të reja, të plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në ofertë dhe të respektohen të gjitha kushtet e përcaktuara në Udhëzues.

6.	A mund të aplikojmë edhe nëse biznesi ka obligime ndaj administratës tatimore dhe është pjesë e një marrëveshjeje për pagesa?	- Bizneset që kanë obligime tatimore dhe janë pjesë e një marrëveshjeje për shlyerjen e borxhit me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), mund të aplikojnë me kusht që kjo të dëshmohet përmes vërtetimit tatimor të vlefshëm dhe marrëveshjes për shlyerjen e tyre me ATK-në.
7.	Sa duhet të jetë pjesëmarrja financiare nga ana jonë si biznes?	- Bashkëfinancimi duhet të jetë minimumi 10% dhe maksimumi 49% e kostos totale të projektit.
8.	A kërkohet që biznesi ta realizojë pagesën e plotë të pajisjes paraprakisht dhe më pas të bëhet rimbursimi nga MZHR, apo pagesa realizohet në formë avansi/granti sipas kontratës?	- Sipas kontratës që lidhet ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe përfituesit, MZHR do të ekzekutojë pagesën e grantit në dy këste. Kësti i parë do të realizohet në formë avanci në vlerë prej 50% të shumës së miratuar, ndërsa kësti i dytë në vlerë prej 50% do të ekzekutohet pas përmbylljes së projektit dhe përbushjes së kushteve kontraktuale.
9.	A lejohet aktivitetet sherbyse te Arkitektures? perkatesisht aktivitetet primare 7111 dhe sekondar 7112 ?	- Kodi Përshkrimi 7111 Aktivitetet e arkitekturës 7112 Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik Kodet dhe aktivitetet e përshkruara kanë kuptim shumëdimensional, megjithatë si aktivitetet të arkitekturës nuk përjashtohen nga financimi me kusht që të plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në Udhëzuesin për aplikim.
10.	Para shpalljes se ketij granti, kam nenshkuruar kontrate qeraje (shfrytezim hapësirje) per zhvendosje te lokacionit te zyres (Nga Komuna e Shtimes ne Komunen e Prishtines), e cila do hyje ne fuqi nga data 1 qershor 2026, kur edhe do aplikoj per ndrrim lokacioni te statusit ne ARBK (konkretisht Adresen). A ka ndonje problem lidhur me kete per Aplikim ne grant?	- Adresa juaj duhet të përcaktohet në rajonin zhvillimor përkatës ku ju aplikoni.
11.	Pyetja ime sa i perket vleres te mbeshtur nga mjetet e grantit p.sh 30.000 euro jami duke aplikuar dhe dua te participoj , me 30% a hyn kjo shume dhe ne 30% apo participimi eshte jashta vleres ?	- Sqarimin e gjeni në fund të tabelës me pyetje dhe përgjigje.
12.	Ne si kompani ne çertifikaten e biznesit kemi adresen ne Prishtinë ndersa me filiale/fabriken e kemi në Mitrovicë.Pyetja është ne si komoani ne cilin Rajon Zhvillimor duhet te aplikojm. Qendër apo Veri.	- Nëse kompania është e regjistruar në ARBK me adresë kryesore në Prishtinë, ndërsa aktiviteti prodhues/shërbyes që lidhet me projektin zhvillohet në filialin/fabrikën në Mitrovicë, aplikimi duhet të lidhet me rajonin ku do të realizohet projekti.

13.	<p>Biznesi im është regjistruar më 02.06.2025 dhe ka deklaruar në ATK një qarkullim vjetor prej 20,000 euro për vitin 2025 (për periudhën qershor–dhjetor), a konsiderohemi “biznes ekzistues” i pranueshëm për këtë thirrje, duke pasur parasysh që plotësojmë kriterin e qarkullimit (10,000–300,000 euro), por aktiviteti i biznesit ka filluar brenda vitit 2025?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Biznesi konsiderohet i pranueshëm për aplikim edhe pse është regjistruar në TM2 të vitit 2025, për sa kohë që plotëson kushtet e përcaktuara në Udhëzuesin për aplikim.
14.	<p>A mundeni te na informoni a mund te kualifikohen edhe ato biznese qe jane regjistruar se fundi ne vitin 2026 apo kah fundi I viitit 2025, e te cilat kishin qarkullimin zero per vitin 2025 ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bizneset që janë regjistruar gjatë vitit 2026, nuk kualifikohen për më shumë arsye (nuk kanë listë të punëtorëve për vitin 2025, nuk kanë qarkullim vjetor për vitin 2025, etj.). - Bizneset që janë regjistruar gjatë vitit 2025 dhe nuk kanë realizuar qarkullim ose kanë deklaruar qarkullim zero për vitin 2025, nuk i plotësojnë kushtet e pranueshmërisë për këtë thirrje.
15.	<p>Kemi pare shpalljen per mbeshtetje te bizneseve nga ana juaj, nje nderi kriteret ishte qe qarkullimi vjetor i biznesit te ishte per vitin 2025 mbi 10 mije euro, ndersa ne kemi vetem 9800 euro, pyetja eshte kjo a mund te aplikojm apo do te penalizohemi shume nga qarkullimi vjetor i biznesit ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kriteri i qarkullimit vjetor prej 10,000 euro deri në 300,000 euro për vitin 2025 është kriter i detyrueshëm i pranueshmërisë për aplikim në këtë thirrje.
16.	<p>Jemi të interesuar të parashtrojmë kërkesë për mbështjetjen financiare në THIRRJE PUBLIKE PËR PROGRAMIN PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR 2025, por Ju lutem që të na informoni se thirrja në fjalë a mbështet pikat si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. 3D printer 2. Plloter për shtyp (dimensioneve më të mëdha) 3. Smart tv (touch smart tv për prezantimin e projekteve). 4. PC (kompjuter me kapacitete më të larta) 5. Software të licencuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Pajisjet dhe softuerët e listuar mund të jenë të pranueshëm për financim në kuadër të kësaj thirrjeje, me kusht që të jenë të lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e regjistruar të biznesit dhe të arsyetohen në projekt-propozim.
17.	<p>E kam një pyetje ju lutem me njoftoni se a pranohen si shpenzime pirunari per bartjen e prodhimeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Pajisja e listuar (pirunari) llogaritet si makinë lëvizëse rrjedhimisht nuk është pajisje e kualifikueshme bazuar në udhëzuesin për aplikim.

18.	Do të dëshiroja me apliku për “Programin e Zhvillimit Rajonal të Balancuar” dhe kam një pyetje: a duhet që ofertat për makineri të jenë në gjuhën shqipe, apo është në rregull nëse i dorëzoj në gjuhën angleze në formatin original.	- Ofertat mund të dorëzohen edhe në gjuhën angleze në formatin e tyre original, me kusht që të përmbajnë specifikimet sipas përshkrimit në udhëzuesin për aplikim.
19.	Në pikën 4 kërkohet lista e punëtorëve. Duke qenë se operoj si biznes individual dhe aktualisht nuk kam punëtorë të angazhuar, të gjitha aktivitetet e biznesit i kryej personalisht si pronar dhe i paguaj rregullisht obligimet e mia ndaj institucioneve përkatëse.	- Lista e punëtorëve, është kriter për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar me udhëzuesin për aplikim, sqarim shtesë lista e punëtorëve lëshohet për biznese edhe kur kemi vetëpunësim po edhe në rastet kur biznesi nuk ka punëtor.
20.	Lidhur me pikën 2, ku kërkohet qarkullimi vjetor, ju lutem më konfirmoni nëse mund të bashkëngjis Deklaratën PD për vitin 2025 si dëshmi të qarkullimit vjetor, apo nëse kërkohet ndonjë dokument tjetër, si p.sh. gjendja e përgjithshme nga ATK.	- Lidhur me dëshminë e qarkullimit vjetor, dokumentacioni i dorëzuar duhet të mundësojë verifikimin e qarkullimit vjetor të deklaruar për vitin 2025, në përputhje me kërkesat e thirrjes, (Qarkullimet për TM1, TM2, TM3 dhe TM4)
21.	Duke i'u referuar pikes "Kriteret e kualifikimit", nen pikes " Të jenë të regjistruar për aktivitetet që parashihen në projekt-propozim, në kohën e aplikimit; (veprimtaria primare apo sekondare në Certifikatë të biznesit të përkoj me projekt propozimin me të cilin aplikohet në këtë thirrje)", i'u njoftojme qe kompania jone ne kuader te aktivitetit/veprimtarise primare ka "Agjencinë për publicitet" dhe po planifikojme te aplikojme per Makineri prodhuese CNC te materialeve publicitare/marketingut, dhe që në parim është brenda fusheveprimit te kompanise sone, andaj ju lutem per konfirmim nga ana juaj qe mund te vazhdojm me aplikim ne menyre qe te sigurohemi se pastaj nuk diskualifikohem per kete kriter?!	- Në udhëzues kërkohet që veprimtaria primare ose sekondare në certifikatën e biznesit të përkojë me projekt-propozimin.
22.	A mund te jete shuma totale e investimeve nën 16000€ apo duhet respektuar gjithsesi shumen minimale te vendosur ne thirrjen publike.	- Sipas udhëzuesit për aplikim shuma minimale e kërkuar nga MZHR është 16,000€

23.	<p>Biznesi jone mikro operon ne lemin e gastronomise (sherbimit), respektivisht si aktivitet primar e ka 'Aktivitetet sherbyese te pijeve', ndersa si aktivite te sekondare i ka 'Restorantet dhe aktivitetet sherbyese te ushqimit' dhe 'Aktivitetet e tjera te argetimit dhe rekreacionit'. Biznesi ka nevojte per investime te reja andaj jemi te interesuar te perfitojme nga granti ne fjale. Perpara se te futemi ne procesin e aplikimit e kemi te domosdoshme te informohemi nese jane te pranueshme per financim kostot ne vijim: Tavolinat dhe karriget, TV, Ventilim, Banaku, Aparati i akullit, Enelaesja, Frizat, Kompjuteri, Ndriçim, Çadrat.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bizneset që operojnë në sektorin e gastronomisë mund të aplikojnë në kuadër të kësaj thirrjeje, me kusht që të plotësojnë kriteret e pranueshmerisë të përcaktuara në Udhëzuesin për aplikim, megjithatë, sa i përket pajisjeve të listuara: Tavolinat dhe karriget, TV, Ventilim, Banaku, Kompjuteri, Ndriçim, Çadrat janë pajisje që nuk kualifikohen për financim).
24.	<p>Jemi firm sherbyese e arkitektures dhe inxhinjerise qe punojm me hartimin e projekteve banesore, industriale, rrugore etj, pra merrum vetem me sherbime projektimi. Planifikojm te rrisim veprimtarin e sherbimeve ne fushen e inxhinjeris, saktesisht deshirojm ne kuader te firmes tone te hapim nje laborator per materiale ndertimore.Pytja jone eshte: A jemi kandidat potencial per aplikim te grantit per paisje laboratorike per materiale te ndertimi (Mostra te betonit, te çelikut, asfaltit, zhavorrit etj)?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në udhëzues kërkohet që veprimtaria primare ose sekondare në certifikatën e biznesit të përkojë me projekt-propozimin.
25.	<p>Pyetje ne cilin platform mund ta plotsoj dokumentat qe ekom përgaditë?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Aplikimi, ngarkimi i dokumentacionit dhe i gjithë procesi bëhet përmes platformës e-Kosova.
26.	<p>Pyetja eshte a mundemi ne si kompani te aplikojme kete vit ne kete skeme, me kompanine ku une nuk kam perfituar asnjeher por aksionari tjetet ka perfituar vitin e kaluar. E perserise kompania eshte SHPK?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në udhëzues përcaktohet se Bizneset (pronarët, aksionarët apo të autorizuarit e tyre) që kanë përfituar nga thirrjet e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar gjatë viteve 2024 dhe 2025, si dhe përfituesit e PZHRB 2022, 2023, 2024 dhe 2025 që nuk kanë realizuar me sukses projektet e tyre nuk kualifikohen për të përfituar nga kjo thirrje.

27.	<p>Fatkeqësisht, vegëza për aplikim nuk është valide dhe nuk po mund të qasemi në formular. A do të kishit mundësi të na dërgonit formularin e aplikimit, të paktën për ta shqyrtuar dhe analizuar pyetësin derisa të rregullohet qasja në vegëzën zyrtare ose te beni ndonje zgjidhje? Gjithashtu, procesi i aplikimit përmes platformës eKosova po na duket paksa i ndërlikuar. Nëse dispononi ndonjë udhëzues, tutorial ose material informues për mënyrën e aplikimit përmes eKosova platformës, do t'ju ishim mirënjohës nëse mund ta ndani me ne.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Aplikimi bëhet përmes platformës e-Kosova e cila është aktive dhe funksionale, Udhëzuesi dhe materialet tjera përcjellësi i gjeni në ueb faqen e MZHR-së https://mzhr.rks-gov.net/thirrje-per-propozime-programi-per-zhvillim-rajonal-te-balancuar-grante-per-biznese/
28.	<p>Ne thirrjen per "Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla-per bizneset ekzistuese", te paragrafi Sektorët e përjashtuar nga financimi, eshte perfshire Ndërtimtaria si dhe shërbimet e ndërlidhura me ndërtimtarinë. A nenkupton kjo qe edhe kompanite qe ofrojne sherbime te Arkitektures jane te perjashtuara nga mundesia per financim?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimtaria si sektor përjashtohet nga kjo thirrje, megjithatë, përjashtim bëjnë pajisjet dhe makineritë për prodhimin e materialeve ndërtimore. Nuk kualifikohen: ndërtimi i objekteve, blerja e mjeteve lëvizëse apo aktivitete të ngjashme, si dhe shërbimet e ndërlidhura me ndërtimtarinë.
29.	<p>A mund te me informoni me teper per Grantin i cili do ti ndihmoje ndermarrjet prodhuese dhe sherbyese ne vend , me qarkullim 10,000 deri 300,000 euro? A vlen p.sh per biznesin tim qe kemi agjension turistik ,qarkullimi perputhet si dhe qarkullimi poashtu .</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Biznesi si i tillë nuk përjashtohet, por duhet përmbushë / plotësoj kriteret e thirrjes.
30.	<p>Qfar nenkupton kjo: Të jenë ndërmarrje me pronësi 100% private, të regjistruara në Kosovë sipas ligjeve në fuqi?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - “Ndërmarrje me pronësi 100% private” nënkupton që biznesi duhet të jetë në pronësi të plotë të personave fizikë ose juridikë privatë dhe nuk duhet të ketë asnjë pjesëmarrje pronësore të shtetit, komunave, ndërmarrjeve publike, agjencive publike apo institucioneve të tjera publike.
31.	<p>Pyetje vlera e grantit apo projektit te jete ne mes range 16.000 -30.000 euro ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në kuadër të kësaj thirrjeje, shuma prej 16,000 € deri në 30,000 € i referohet vlerës së grantit që mund të kërkohet nga MZHR,

32.	<p>Kompania ime është e regjistruar që nga data 21.01.2014 me emrin _____, me veprimtari në fushën e teknologjisë informative, riparimit të kompjuterëve dhe pajisjeve teknologjike. Nga fundi i vitit 2020 deri tani, aktiviteti i biznesit ka qenë i ndërprerë për shkak të zhvendosjes time për jetesë dhe punë në Suedi, si dhe ndikimit të periudhës së pandemisë COVID-19. Për këtë arsye, biznesi nuk ka realizuar qarkullim gjatë vitit 2025, megjithëse kompania ka mbetur aktive dhe e regjistruar gjatë gjithë kohës. Para ndërprerjes së aktivitetit, kompania ka operuar normalisht dhe ka pasur qarkullim vjetor mbi 100,000 euro në vitet aktive të operimit. Dëshiroj të di:</p> <p>A mund të merret parasysh historia dhe vazhdimësia e biznesit tim, pavarësisht mungesës së qarkullimit në vitin 2025, apo kriteri i qarkullimit është kusht i domosdoshëm pa përjashtim për kualifikim në këtë thirrje?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Sipas kushteve të përcaktuara në udhëzuesin për aplikim një nga kriteret e pranueshmërisë është që aplikuesi të ketë qarkullim vjetor të deklaruar në ATK për vitin 2025 në vlerë prej minimum 10,000 euro dhe maksimum 300,000 euro.
33.	<p>Pyetja është si ne vijim: A i mbështetni blerjen e pajisjeve të përkthimit dhe zerimit. Blerjen e serverëve, llaptopeve, PC dhe gjerave të nevojshme elektronike për kompaninë pasi që ne jemi pothuajse 80% kontraktues të institucioneve publike. Ne se jo çka mbështetni prej pajisjeve elektroni.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në parim pajisjet teknologjike dhe elektronike mund të jenë të pranueshme për financim në kuadër të kësaj thirrjeje, me kusht që plotësohen edhe kriteret e tjera të udhëzuesit për aplikim dhe të thirrjes në përgjithësi.
34.	<p>Jam i interesuar për aplikim granti po e-kosova spol bon qysh kisha mujt meja bo?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Aplikimi bëhet përmes platformës e-Kosova e cila është aktive dhe funksionale, - Udhëzuesi dhe materialet tjera përcjellësi i gjeni në ueb faqen e MZHR-së
35.	<p>Ndërsa bizneset të cilat kanë realizuar qarkullim mbi 300,000 euro kualifikohen të aplikojnë?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Sipas kushteve të përcaktuara në Thirrjen Publike, aplikuesit / bizneset potencial duhet të kenë qarkullim vjetor të deklaruar në ATK për vitin 2025 në vlerë prej minimum 10,000 euro dhe maksimum 300,000 euro.

<p>36. Aktiviteti kryesor i kompanis tone eshte perpunimi dhe paketimi i specit feferon sipas standardeve per turshi. Specin feferon mild-pikant ne e grumbullojme nga fermeret lokal dhe si produkt final e eksportojm kryesisht ne Gjermani, Shqiperi dhe Italy. Aktiviteti kryesor i kompanis tone eshte me kodin: 1039 - Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve si dhe Sekondar: 0113 Kultivimi i perimeve, pjepërave dhe shalqirit, bimëve rrënjore dhe tuberoze.</p> <p>Ju lutemi a mundet që kompania jone të kualifikohet për mbështetje financiare sipas thirrjes publike nën Masa 2.3 Mbështetje për biznese ekzistuese?</p>	<p>- Bujqësia është sektorë që përjashtohet nga financimi në këtë thirrje për propozime, përfshirë çdo pajisje apo aktivitet që lidhet me veprimtari bujqësore, megjithatë përjashtim bëjnë makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve, të cilat nuk financohen nga MBPZHR.</p>
<p>37. Sipas udhëzuesit kërkohet ngarkimi i ofertës/profaturës për pajisjet apo softuerin që planifikohet të finanohet. Mirëpo, në rastin e softuerëve ndërkombëtarë dhe abonimeve online (p.sh. Adobe Photoshop, Adobe Illustrator/AI dhe platforma të ngjashme), kompanitë zakonisht nuk lëshojnë profaturë klasike me vulë dhe nënshkrim. A pranohen si dëshmi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • screenshot nga web-faqja zyrtare me çmimin/paketën, • checkout page, • invoice automatike PDF, • email konfirmimi i pagesës apo abonimit, • ose dëshmi të ngjashme elektronike? 	<p>- Tek dokumentet e kërkuara për aplikim lexo dhe përmbaju pikës 6, faqe 12 të Udhëzuesit për aplikim.</p>
<p>38. Kam një pyetje lidhur me përkrahjen për bizneset ekzistuese në kuadër të thirrjes për grante. A janë të pranueshme për aplikim bizneset e themeluara gjatë vitit 2025 në fundvit, të cilat janë të regjistruara dhe aktive, mirëpo ende nuk kanë arritur qarkullim vjetor mbi 10,000 euro?</p>	<p>- Regjistrimi i biznesit edhe në periudhën e vonshme të vitit 2025 është kriter i kualifikueshëm por duhet plotësohen kushtet dhe kriteret e tjera të thirrjes për aplikim (lexo udhëzuesin për aplikim).</p>

39.	<p>Në rast se një kompani ka dëshmuar ndër vite qarkullim të rregullt dhe stabil (p.sh. prej vitit 2021 me qarkullim mbi 80,000€ në vit), mirëpo gjatë viteve 2024 dhe 2025 ka pasur rënie ose mungesë të aktivitetit për arsye shëndetësore të pronarit të kompanisë, a mund të konsiderohet kjo si rrethanë përjashtuese dhe të merret parasysh historia paraprake e biznesit gjatë vlerësimit të aplikimit?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Me kushtet dhe kriteret e thirrjes për aplikim PZHRB 2026 dhe Udhëzuesin e sajë nuk janë parapara kushte dhe rrethana specifike, (siç ju i përshkruani) rrjedhimisht kushtet dhe kriteret e thirrjes për aplikim PZHRB 2026 dhe Udhëzuesi janë kritere që Komisionet vlerësuese të MZHR-së i respektojnë në plotësi.
40.	<p>është i regjistruar si Shoqëri Aksionare (SH.A.) me vetëfinancim, pa kapital shtetëror. Kemi nevojë të konfirmojmë nëse është e pranueshme sipas kushteve të kësaj thirrjeje. NUMRI I PUNONJËSVE- , numëron aktualisht 28 (njëzet e tetë) punonjës. Sipas klasifikimit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, kjo e kategorizon si ndërmarrje të vogël (10 - 49 punonjës). Ju lusim të konfirmoni nëse kjo kategori është e pranueshme për Nën Masën 2.3.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bazuar në përshkrimin që keni bërë, aplikimi me biznesin tuaj është i kualifikueshëm për aplikim në kuadër të kësaj thirrjeje, Sa i përket numrit të punësuarve, një ndërmarrje me 28 punonjës klasifikohet si ndërmarrje e vogël
41.	<p>Jemi ndërmarrje mikro me qarkullim brenda kriterit minimumi 10,000 maksimumi 300,000.00. Merrem me instalimin e e sistemeve hidro sanitare ofrojmë shërbime montimi e qeramikave a kem drejt te aplikojmë për një makinë qe bën prerjen e pllakave - qeramikave me presion te ujit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimtaria si Sektor përjashtohet nga kjo thirrje, megjithatë, përjashtim bëjnë pajisjet dhe makineritë për prodhimin e materialeve ndërtimore. Nuk kualifikohen: ndërtimi i objekteve, blerja e mjeteve lëvizëse apo aktivitete të ngjashme, si dhe shërbimet e ndërlidhura me ndërtimtarinë;
42.	<p>A pranohet TVSH-ja si shpenzim i pranueshëm në kuadër të projektit, respektivisht a mund të dorëzohen ofertat dhe faturat me TVSH të përfshirë? Gjithashtu, ju lutem na konfirmoni nëse kjo vlen edhe për bizneset të cilat janë të regjistruara si deklaruese të TVSH-së.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Lexo “Kostot e papranueshme”, faqe 10 dhe referohu specifikisht në pikën: <i>Tatimet dhe tarifat si: tatimet mbi të ardhurat, tarifat bankare, shpenzimet për garanci dhe tarifa të ngjashme.</i>

43.	Pyetja ime eshte, pjesa e bashkefinancimit a duhet te jete brenda totalit 30 mij apo ne mund te shtojme p.sh edhe 20 mij euro mbi shumen 40 mij, qe dmth projekti te jete total 50 mij euro.	- Kontributi mund të jetë me një shumë më të lartë se minimumi i kërkuar i bashkëfinancimit. Shuma prej 16,000 € deri në 30,000 € i referohet vlerës së grantit që mund të kërkohet nga MZHR, ndërsa vlera totale e projektit mund të jetë më e lartë përmes kontributit tuaj financiar. % e bashkëfinancimit duhet të jetë brenda limiteve 10 – 49 %
-----	--	--

Shembuj me shumat e financimit dhe bashkëfinancimit

Rasti 1

Financimi nga MZHR: 16,000.00 €

Bashkëfinancimi: 10% (minimumi i lejuar)

- Kosto totale e projektit: 17,777.78 €
- Bashkëfinancimi i aplikantit: **1,777.78 €**

Burimi Shuma (€)

MZHR 16,000.00

Aplikanti 1,777.78

Totali 17,777.78

Rasti 2

Financimi nga MZHR: 16,000.00 €

Bashkëfinancimi: 49% (maksimumi i lejuar)

- Kosto totale e projektit: 31,372.55 €
- Bashkëfinancimi i aplikantit: **15,372.55 €**

Burimi Shuma (€)

MZHR 16,000.00

Aplikanti 15,372.55

Totali 31,372.55

Rasti 3

Financimi nga MZHR: 30,000.00 €

Bashkëfinancimi: 10% (minimumi i lejuar)

- Kosto totale e projektit: 33,333.33 €
- Bashkëfinancimi i aplikantit: **3,333.33 €**

Burimi Shuma (€)

MZHR 30,000.00

Aplikanti 3,333.33

Totali 33,333.33

Rasti 4

Financimi nga MZHR: 30,000.00 €

Bashkëfinancimi: 49% (maksimumi i lejuar)

- Kosto totale e projektit: 58,823.53 €
- Bashkëfinancimi i aplikantit: **28,823.53 €**

Burimi Shuma (€)

MZHR 30,000.00

Aplikanti 28,823.53

Totali 58,823.53

Përmbledhje:

	MZHR (€)	% Bashkëfinancim	Bashkëfinancimi i aplikantit (€)	Totali i projektit (€)
1	16,000.00	10%	1,777.78	17,777.78
2	16,000.00	49%	15,372.55	31,372.55
3	30,000.00	10%	3,333.33	33,333.33
4	30,000.00	49%	28,823.53	58,823.53